

CARMEN ALINA GJANI

Nga dhjetori 2021 mban detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Ajo është me origjinë rumune dhe me nënshtetësi shqiptare, e diplomuar me titull master shkencor, në Fakultetin e Filologjisë në Universiteti i Bukureshtit. Ka një eksperience 15 vjeçare në fushën e medias dhe komunikimit publik dhe gjatë karrierës së saj është angazhuar në një larmi detyrash në cilësinë e ekspertit të komunikimit dhe menaxhimin e medias.

Nga viti 2000 deri në 2002 ka ushtruar detyrën e Koordinatorit për Riatdhesimin e Azilkërkuesve pranë Zyrës për Refugjatet në Ministrinë e Pushtetit Lokal në Shqipëri.

Nga viti 2002-2005, është rikthyer në Bukuresht në Ambasadën e Shqipërisë në Rumani ku shoqëroje bashkëshortin i emëruar në shërbimin diplomatik. Në 2005, me rikthimin në Tiranë, ka ushtruar detyrën e menaxheres së marketingut në Revistën Klan , gazetën Korrieri dhe Albanian Daily News deri në vitin 2007, kur emërohet Administrator i Përgjithshëm e gazetës 'Koha Jone', detyrë që e ka mbuluar deri në vitin 2011.

Nga viti 2011-2015 është emëruar si anëtare bordi në grupin mediatik Panorama Group me detyrë përgjegjëse për projektet e zhvillimit në tregun e mediave dhe Drejtore editimi në Revistën Psikologjia, pjesë e Panorama Group.

Nga viti 2015 deri në vitin 2017 ka mbuluar detyrën e Këshilltares për media në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të Drejtores së kabinetit në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Nga janari 2019 deri në nëntor 2021 ka mbajtur detyrën e Këshilltares për media në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.